



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:220960  
Datë: 22.12.2021  
Numri i dokumentit: 02542902

Ac.nr.9969/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zenel Leku - kryetar i kolegjit, Faton Ademi, Rustem Thaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve-propozuesve N.B dhe A.B që të dy nga "...", Bashkia Durrës, Republika e Shqipërisë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson I.S, avokat nga Deçani, kundër të paditurëve-kundërpropozuesve "R..." sh.p.k me seli në rr."..." ..., Prishtinë, të cilin e përfaqëson Y.B nga Istogu, rr."..." nr., J.ZH me vendbanim në Kragujevc, rr."...", nr., Republika e Serbisë, S.ZH nga ....., p.n, Republika e Serbisë, Z.ZH nga ....., rr....., Republika e Serbisë, D.ZH, nga Beogradi, rr.... nr..., Republika e Serbisë, R.ZH nga Beogradi, Rr.... nr...., Republika e Serbisë dhe L.O nga Kragujevci, Rr.... .., Republika e Serbisë, nga baza juridike vërtetimin e nulitetit të kontratës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve-propozuesve të sigurimit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr768/21, datë 04.10.2021, seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.12.2021, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa e së autorizuarit të paditësve-propozuesve N.B dhe A.B që të dy nga Bashkia Durrës, Republika e Shqipërisë, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.768/21, datë 04.10.2021.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e atakuar C.nr.768/21, datë 04.10.2021, ka vendosur si në vijim: *"I. REFUZHET si i pabazuar propozimi i paditësve – propozuesve N.B dhe A.B, me cka kanë kërkuar të ÇAKTOHET MASA E PERKOHSHME E SIGURISE, dhe ti NDALOHET*

*kundërshtarit të sigurimit “R..” shpk me seli në rr. “Lot Vaku” ..., Prishtinë, të cilin e përfaqëson Y.B nga Istogu, Rr. “...” nr.96, që mos të shes mos të kontraktot dhe të vërtetojnë kontratën për shitblerjen e paluajtshmërive tek Noteri kompetent për territorin e Komunës së Istogut, dhe me gjerë, të mos ndertoje drejtpërdrejt ose përmes personave të tret, mos ta hipotekoj ngastrën kadastrale P 708060020-00370-2, në sipërfaqe prej 13077 m2, ngastrën P-7086020-00370-1, në sipërfaqe prej 4372m2, dhe ngastrën kadastrale P-70806020-00371-0 në sipërfaqe prej 20707m2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 38154m2, Zona Kadastrale në Istog, për derisa procedura kontestimore të përfundoj me aktgjykim të formës së prerë, apo deri në ndonjë vendim tjetër të Gjykatës, e nën kërcënimin të pasojave ligjore.*

*II. Procedura në këtë çështje juridike – konstetimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës”*

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i paditësve/propozuesve të sigurimit në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur të paditurit/kundërshtarët e sigurimit .

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitave nga nenet 208 dhe 209 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve-propozuesve të masës së përkohshme është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se palët paditëse -propozuesit përmes të autorizuarit të tyre me datën 01.10.2021 kanë paraqitur padi për shkak të vërtetimit të nulitetit të kontratës, në kuadër të së cilës është propozuar caktimi i masës së përkohshme, me kërkesë që ti ndalohe kundërshtarit të sigurimit “R...” sh.p.k me seli në Prishtinë, që të mos shetë, të mos e kontraktotë, dhe vërtetojnë kontratën për shitblerjen e paluajtshmërive tek noterët kompetent, përderisa procedura kontestimore të përfundoj me aktgjykim të formës së prerë.

Gjykata e shkallës së parë jashtë seance ka marr aktvendimin e atakuar me ankesë, C.nr.768/21, datë 04.10.2021, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës gjykata e shkallës së parë nuk e ka përmbushur obligimin ligjorë që ta shqyrtoj ankesën se a i plotëson kushtet ligjore për të kaluar në gjykatën e shkallës së dytë për tu trajtuar, kjo nisur nga fakti se gjyqtari i çështjes në udhëzimin në mjetin juridik të vendimit ka konstatuar se kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa. Në raste të tilla gjykata e shkallës së parë është dashur që ta hedh ankesën dhe mos ta përcjell në gjykatën me të lartë.

Meqë gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr një veprim të tillë, Gjykata e Apelit pas vlerësimit të ankesës së paraqitur nga i autorizuari i paditësve-propozuesve të masës, duke ju referuar nenit 310 par.5 LPK-së, në të cilën dispozitë qartë është përcaktuar se ankesa nuk është e lejuar, vendosi që ankesa e paraqitur nga paditësit/propozuesit duhet të hedhet poshtë si e palejuar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:220960  
Datë: 22.12.2021  
Numri i dokumentit: 02542902

Nga arsyet e paraqitura, bazuar në dispozitën e nenit 209 pika (a) e lidhur me nenin 208 të LPK-së, u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.9969/21, me datë 16.12.2021

Kryetari i kolegjit  
Zenel Leku